



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 9

Tiranë – E hënë, 3 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 1888, datë 23.3.2017	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës për “Vlerësimi i dinamikës së skemës NE si pasojë e ndikimit të formulës së pikëzimit, me fokus targetimin te familjet e varfra, të përfituesve aktuale të skemës së NE në zonat pilote” 3
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve nr. 984, datë 1.3.2017	Vendim i Komisionit të Ankimit..... 4



**KËRKESË E MINISTRISË SË
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**
Nr. 1888, datë 23.3.2017

**PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË
ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)**
Tiranë, më 20 mars 2017

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIME KONSULENCE
PËR**

“Vlerësimi i dinamikës së skemës NE si pasojë e ndikimit të formulës së pikëzimit, me fokus targetimin te familjet e varfra, të përfituesve aktuale të skemës së NE në zonat pilote”

Numër reference: SAMP/CS/CQ/04-2015

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)

Hua No.: 8141- AL

Nr. i identifikimit të Projektit. P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale (“Shërbim”) përfshin **“Vlerësimi i dinamikës së skemës NE si pasojë e ndikimit të formulës së pikëzimit, me fokus targetimin te familjet e varfra, të përfituesve aktuale të skemës së NE në zonat pilote”**.

Qëllimi i këtij studimi është për të kontrolluar/verifikuar saktësinë e informacionit të dhënë nga ana e aplikantëve/përfituesve (si një *spot-check*/auditimit), si dhe për të kuptuar karakteristikat e familjeve përfituese.

Në bashkëpunim të ngushtë me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara në MMSR, kompania lokale do të jetë përgjegjëse për auditimin e statusit aktual të mirëqenies së përfituesve të NE dhe karakteristikat e tyre në zonat pilot, verifikimin e kushteve të familjeve bazuar në informacionin e dhënë në format e tyre të aplikimit. Pra, studimi (nëpërmjet një sondazhi) kryesisht do të mbledhë informacion që është dhënë në aplikim, e që, gjithashtu, do të mund të mbledhë disa informacione shtesë për të kuptuar më mirë gjendjen dhe karakteristikat/mirëqenien e familjeve përfituese.

Studimi do të përfshijë mbledhjen e të dhënave duke përdorur për efekt studimi 8% të kampionit të përfituesve në tri zona pilote (duke u siguruar që mostrat e zgjedhura të jenë përfaqësuese të përfituesve) ekuivalente me 2238 anketues pyetësorë.

1. Pritet që personeli kyç i konsulentëve të kenë aftësi dhe përvojë si më poshtë:
2. • **Udhëheqësi i Ekipit** me shumë përvojë në anketime, zbatimin e metodologjisë dhe procedurave të marrjes së mostrave dhe të jetë në gjendje për të përmbledhur dhe përgatitur një raport teknik përfundimtar me rekomandimet përkatëse për gjetjet e studimit. Udhëheqësi i ekipit duhet të ketë së paku 10 vjet përvojë përkatëse profesionale në fushat e sipërpërmendura.
3. • **Ekspert Statistike Metodologjist**, me shumë përvojë në statistika, me histori të provueshme në zhvillimin e metodologjisë në anketën familjare.
4. • **Ekspert Statistike për Sondazhe**, me shumë përvojë në statistika, me histori të provuara të punës në sondazh.
5. • **Ekspert Social** me përvojë të mëparshme në të dhënat e analizave dhe studimeve kërkimore në fushën sociale;
6. • **Ekspert Social Statisticien**
7. Firma konsulente mund të punësojë ekspertë të tjerë për të zbatuar detyrën me standarde të larta. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton të gjitha kompanitë konsulente lokale (“Konsulente”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit janë:

Kriteret e shortlistimit	Pikët
Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit	30 pikë
Numri i shërbimeve që kanë lidhje me kontratën, të përfunduara gjatë pesë viteve të fundit.	20 pikë
Eksperienca specifike në fushën e shërbimit.	30 pikë
Përvoja të ngjashme me detyrën dhe kualifikimet e stafit kryesor.	20 pikë
TOTALI	100

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së dhe*



Grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore (“Udhëzuesi i konsulencës”) - version i janarit të 2011-s.

Shërbimi i konsulencës pritet të kryhet për një periudhë 4-mujore. Konsulenti pritet të fillojë punë në prill 2017 dhe të përfundojë nga korriku 2017.

Shërbimi do të kryhet nga një kompani lokale konsulente. Metoda e përzgjedhjes do të jetë Kualifikimet e konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore: *Përzgjedhja e punësimit i konsulentëve të Bankës Botërore (botimi 2011)* (edition of 2011).

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **3 prill 2017**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
“Rruga e Kavajës”, AL-1001, Tiranë,
ALBANIA
Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

VENDIM

Nr. 984, datë 1.3.2017

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të

Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 13, datë 22.1.2017, të ISHMP-së, Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit fizik/juridik **“Agostin Zefi”**, protokolluar me nr. 436 prot., datë 30.1.2017.

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 137, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni i ankimit,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit me gjobë në vlerën 30.000 lekë, nr. 13, datë 22.1.2017, të ISHMP-së, Dega Rajonale Tiranë, rrëzimin e ankimit të subjektit “Agostin Zefi” ndaj këtij vendimi administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR
Ergys Agasi

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.